



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 02/08/2022 Ref.: 1036/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018, datë 28.09.2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 103-të mbajtur më 26.07.2022 mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet proگرامi i studimit i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, për periudhën pesë (5) vjeçare, 1 tetor 2022 - 30 shtator 2027:
 1. *Menaxhim Biznesi, BSc 180 ECTS*, me specializimet: 1. Banka dhe Financa; 2. Administrim Biznesi. Maksimumi 200 studentë për vit akademik (150 në gjuhën shqipe dhe 50 në gjuhën boshnjake);
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mbanë përgjegjësi ligjore për moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Haxhi Zeka” në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditim të programit të studimit me stafin akademik si në tabelë;

| Nr. | Programi i studimit | Bartësit e programit |
|-----|---|---|
| 1. | Menaxhim Biznesi, BSc 180 ECTS me specializimet; 1. Banka dhe Financa; 2. Administrim Biznesi. Riakreditim | Husnija Bibuljica Alma Shehu Lokaj Vjosa Hajdari Suada Ajdarpasic Suada Dzogovic Anita Cucovic Driton Sylqa |

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA me datë 14.06.2022 ka organizuar vizitat në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Ramona Rupeiga Apoga dhe Christopher Bohlens.

Bazuar në nenin 17 të Udhëzimit Administrativ MASHT (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për programin në fjalë, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit *Menaxhim Biznesi, BSc 180 ECTS*, me specializimet: 1. Banka dhe Financa; 2. Administrim Biznesi, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) standarde dhe substancialisht pesë (5) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 103-të të mbajtur më 26.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

